



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 06 datë 04.10.2024

PËR
MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: “OBJEKT SHËRBIMI
APART-HOTEL ME 3, 4, 5 DHE 6 KATE MBI TOKË DHE 2 KATE NËNTOKË” ME
VENDNDODHJE NË BASHKINË VLORË

Në mbështetje të neneve 27, 28, 39 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “Vortek” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:


1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Objekt shërbimi apart-hotel me 3, 4, 5 dhe 6 kate mbi tokë dhe 2 kate nëntokë”, me vendndodhje në Bashkinë Vlorë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Vortek” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë i bashkëlidhen këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Vlorë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria Turizmit dhe Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyn në fuqi menjëherë



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
MIRELA KUMBARO FURXHI



ANËTAR / SEKRETFAR I KKT
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 11.06 / 2025